EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8434
E mërkurë, 17 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Limaj kërkon rikthimin në Kuvend të ligjit për procesin gjyqësor në Hagë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SPECIALE I KA DËNUAR ME 41 MUAJ BURGIM THAÇIN, SMAKAJN DHE FAZLIUN, NDËRSA KUÇIN ME NJË MUAJ BURGIM ME KUSHT, PËR VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PENGIMIN E DREJTËSISË

KJO ËSHTË POLITIKË, JO DREJTËSI

FAQE 4-5



Hashim Thaçi është dënuar nga Gjykata Speciale me 17 muaj burgim për vepra penale që lidhen me pengimin e drejtësisë, përfshirë tentativën për pengimin e personave zyrtarë, shkeljen e fshehtësisë së procedurës dhe mosbindjen ndaj gjykatës. Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu janë dënuar me nga 12 muaj burgim, ndërsa Hajredin Kuçi me një muaj burgim me kusht. Isni Kilaj është shpallur i pafajshëm. Smakaj dhe Fazliu janë liruar, pasi dënimin e kanë vuajtur përmes kohës së kaluar në paraburgim. Pas shpalljes së aktgjykimit ka reaguar ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ai është ngritur në këmbë dhe ka thënë: "Kjo është politikë, jo drejtësi"

SAMITI BE - BALLKANI PERËNDIMOR: KOSOVËS DHE SERBISË PRITET T'U KËRKOHET PËRPARIM NË DIALOG

F. 3



MINISTRI ÇEKU NISI NË PRISHTINË KONSULTIMET ME STUDENTËT PËR STRATEGJINË E ARSIMIT 2035+

F. 7



AKTUALE



ÇFARË PRITET NGA SAMITI MES TRUMPIT, XISË DHE PUTINIT? F. 2

PRESIDENTJA TAKON AMBASADORIN JAPONEZ, KËRKON THELLIM TË BASHKËPUNIMIT DHE LEHTËSIM TË UDHËTIMIT PA VIZA F. 3

ALEANCA KËRKON NGA KRYESIA E KUVENDIT KTHIMIN PRAPA TË REKOMANDIMIT PËR SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË KPMSHCK-së F. 6

EKONOMI



ASK: KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË U RRIT PËR 10,74 PËR QIND NË SHTATOR F. 8

GAP: 87 PËR QIND E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË KOSOVËS KONTRIBUUAN NË OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM F. 8

SPORT



JUVENTUSI OFRON SHKËMBIMIN E ZHEGROVËS ME BALOGUNIN? F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ÇFARË PRITET NGA SAMITI MES TRUMPIT, XISË DHE PUTINIT?

UASHINGTON, 17 NËNTOR - Takimi i parë trepalësh mes presidentit amerikan Donald Trump, udhëheqësit kinez Xi Jinping, dhe presidentit rus Vladimir Putin, mund të mos i përmbushë pritjet pavarësisht prej simbolikës së tij që tërheq vëmendjen.

Samiti do të mbahet në margjinat e konferencës të organizatës për Bashkëpunim Ekonomik Azi-Paqësor (APEC) në Shenzhen.

Takimi i nivelit të lartë trepalësh, i propozuar fillimisht nga Putini në tetor dhe i konfirmuar nga Shtëpia e Bardhë më 13 nëntor, ka nxitur edhe krahasime me Konferencën e Jaltës të vitit 1945, që ishte mbajtur në ditët e fundit të Luftës së Dytë Botërore.

Në qytetin turistik të Krimesë, ShBA-ja, Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik, si fitues të luftës, përcaktuan prapa dyerve të mbyllura sferat e ndikimit në periudhën e pasluftës, duke vendosur në praktikë fatin e shumë vendeve më të vogla në Evropë dhe Azi.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, i cili është i shqetësuar ndaj përpjekjeve të Putinit për ta lënë jashtë procesit të formësimit të rezultatit të luftës në shkallë të plotë që Rusia nisi ndaj Ukrainës më 2022, i tha CNN-it: "Ne nuk duam një Jaltë 2.0".

Jo një Jaltë të re

Megjithatë, disa ekspertë i thanë Radios Evropa e Lirë se takimi mes ShBA-së, Kinës dhe Rusisë, më 19 nëntor, do të jetë shumë i ndryshëm nga konferenca historike e mbajtur 81 vjet më parë. "Nuk mendoj se ky krahasim është i duhuri", tha Elizabeth Wishnick, eksperte e marrëdhënieve ruso-kineze në Korporatën CNA në Virxhinia. "Edhe nëse do të kishin dëshirë të merrnin vendime të tilla, nuk do të mund t'i zbatonin ato, sepse bota ka ndryshuar që nga ajo kohë. Ka shumë aktorë të pavarur që kanë mundësi t'i pengojnë fuqitë e mëdha. Mjafton të shohim Gjirin Persik, për shembull".

Bobo Lo, bashkëpunëtor në Institutin Lowy të Australisë, theksoi se Kina është përpjekur të pozicionohet si udhëheqëse e Jugut Global, duke u përqendruar në demokratizimin e raporteve ndërkombëtare. "Ideja që tre udhëheqës botërorë marrin vendime të mëdha për qeverisjen globale bie ndesh me narrativin që Pekini përsërit vazhdimisht, dhe kinezët janë jashtëzakonisht të kujdesshëm ndaj kësaj ideje", i tha ai Radios Evropa e Lirë.

Putini mund të përfitojë më së shumti nga tre udhëheqësit edhe nëse samiti nuk prodhon ndonjë rezultat thelbësor, tha në një intervistë Tsiporah Fried, bashkëpunëtore e lartë në Institutin Hudson në Uashington.

Prioriteti i Xisë

Për Xi Jinpingun, i cili nuk e kërkoi mbajtjen e këtij takimi, menaxhimi i kujdesshëm i imazhit që do të dalë nga ky samit është parësor.

Prioriteti i Xisë "është që takimi të jetë i suksesshëm dhe ta përcjellë imazhin e stabilizimit të raporteve mes fuqive të mëdha. Kina do të përqendrohet te simbolika dhe jo te marrëveshjet konkrete që mund të arrihen", i tha Radios Evropa e Lirë, Yun Sun, drejtoreshë e Programit për Kinën në Qendrën Stimson në Uashington.

Fillimisht, as Pekini dhe as Uashingtoni nuk e pranuan idenë e Putinit për samitin, të cilën ai e propozoi gjatë një bisede telefonike që zhvilloi me presidentin Trump më 9 tetor. Por, më 19 tetor, Trumpi u tha gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë se ishte i gatshëm ta mbante takimin nëse Xi do të pajtohej.

Kina nuk i konfirmoi publikisht diskutimet për takimin trepalësh deri më 4 nëntor.

Më vonë, "The Wall Street Journal" raportoi se Pekini dhe Uashingtoni kishin mospajtime për formatin e takimit. Kina dëshiron që asgjë të mos i lihet



rastësisë dhe po këmbëngul për një takim me agjendë të përcaktuar në detaje dhe me rezultat të paracaktuar, ndërsa Uashingtoni preferon një format më fleksibil, me diskutime të hapura.

Në këtë rast, Pekini është veçanërisht i interesuar ta menaxhojë me kujdes takimin sepse nuk dëshiron që ai ta lërë në hije ngjarjen kryesore të APEC-ut, tha Wishnick nga Korporata CNA.

Veçanërisht Kina i ka rezistuar thirrjes së Putinit për të diskutuar për përfundimin e luftës në Ukrainë. Presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier, i cili së fundi u takua me Xinë gjatë një vizite shtetërore në Kinë, tha në një intervistë për transmetuesin publik gjerman ARD se Xi i kishte thënë se çdo negociatë për konfliktin duhet të përfshijë edhe Evropën, pasi lufta ndikon drejtpërdrejt në sigurinë evropiane.

Në Evropë, "Kina shihet si një faktor që mundëson vazhdimin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës" dhe për këtë arsye duhet të tregohet e kujdesshme, tha Wishnick. Organizimi i një samiti trepalësh, në të cilin Uashingtoni, Moska dhe Pekini do të diskutonin për përfundimin e luftës pa pjesëmarrjen e Ukrainës dhe Evropës, "vetëm do ta ndërlikonte diplomacinë e Kinës ndaj Evropës".

Kinezët "duan një kornizë më të gjerë, në të cilën do të përfshiheshin edhe ukrainasit dhe evropianët", shtoi ajo.

Fokusi i Trumpit: Kontrolli i armëve bërthamore

Për dallim nga objektivat e Xisë dhe Putinit, synimet e Trumpit për këtë takim janë më modeste. Presidenti amerikan nuk ka nevojë ta luajë rolin e mikpritësit, sikurse Xi, e as të përpiqet ta paraqesë veten si të barabartë me fuqitë më të mëdha të botës, siç duhet të bëjë Putini.

Në vend të kësaj, Trumpi synon të diskutojë për çarmatimin bërthamor, një temë për të cilën ka shprehur interesim të madh që nga vitet '80. Në vitin 1984 Trumpi i tha një gazetari të "The Washington Post" se dëshironte të negocionte për kontrollin e armëve bërthamore me Bashkimin Sovjetik në emër të ShBA-së.

Në vitin 2019 administrata e parë e Trumpit e zhvendosi strategjinë bërthamore amerikane nga kontrolli tradicional dypalësh i armëve me Rusinë drejt një kornize trepalëshe që përfshinte Moskën dhe Pekinin.

Në një intervistë për "Newsmax" më 15 tetor, Trumpi tha: "E gjithë kjo çështje është për keqardhje, sepse do të doja ta arrinim çarmatimin bërthamor, nëse është e mundur por, në fakt, po flasim me Rusinë për këtë dhe po flasim edhe me Kinën për çarmatimin bërthamor".

Më 13 nëntor zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Olivia Wales, deklaroi: "Ai do të diskutojë për reduktimin e armëve bërthamore në botë, përhapjen e të cilave presidenti Trump e konsideron shumë të rrezikshme".

Megjithatë, Kina vazhdon të jetë e rezervuar sa i përket diskutimit për kontrollin e armëve bërthamore me ShBA-në dhe Rusinë. "Qëndrimi i Kinës për armët bërthamore është i qartë: Rusia dhe ShBA-ja duhet fillimisht t'i reduktojnë arsenalet e tyre, që janë shumë më të mëdha", para se të nisin çfarëdo diskutimi trepalësh", tha Fried nga Instituti Hudson.

ShBA-ja dhe Rusia së bashku kanë më shumë se 90 për qind të armëve bërthamore në botë, sipas Federatës së Shkencëtarëve Amerikanë, një organizatë hulumtuese me seli në Uashington. Rusia ka 5 459 armë bërthamore, ndërsa ShBA-ja 5 177. Kina, ndërkaq, ka 600.

Megjithatë, Pekini po e zgjeron me ritme të shpejta arsenalin bërthamor. Pentagoni vlerëson se deri në vitin 2035, Kina do të ketë 1 500 koka bërthamore.

Pekini thotë se zgjerimi i arsenalit të tij bërthamor është masë mbrojtëse për të siguruar një kapacitet të besueshëm për kundërpërgjigje ndaj një sulmi bërthamor. Ai ka një politikë të Mospërdorimit i Pari (NFU) të armëve bërthamore dhe zotohet të mos përdorë ose kërcënojë me përdorimin e armëve bërthamore kundër shteteve që nuk i kanë ato, apo kundër zonave që nuk kanë armë bërthamore. "Ka pengesa të mëdha për arritjen e një marrëveshjeje trepalëshe për kontrollin e armëve, veçanërisht për shkak të dallimeve mes tri fuqive bërthamore dhe përparësive të tyre të ndryshme strategjike. Megjithatë, dialogu mes tyre do të ishte i vlefshëm", tha Fried. Sipas saj, sfida qëndron në shndërrimin e këtij dialogu në negociata konkrete, me objektiva të përcaktuara qartë, zotime të ndërsjella dhe një kornizë të dakorduar, e cila do të mundësonte vendosjen e kufizimeve domethënëse dhe të verifikueshme për arsenalet bërthamore të të tria shteteve.

ALEATËT E NATO-S DHE PENTAGONI DISKUTOJNË TËRHEQJEN E MUNDSHME TË TRUPAVE AMERIKANE NGA EVROPA

BRUKSEL, 17 NËNTOR - Aleatët e NATO-s do të diskutojnë për shqyrtimin e Uashingtonit të niveleve të trupave amerikane në Evropë. Këtë, sipas medieve të huaja, ata do ta bëjnë gjatë takimit me shefin e politikave të Pentagonit, Elbridge Colby. Kjo është bërë me dije nga ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, me më shumë qartësi mbi fushëveprimin e çdo tërheqjeje që pritet brenda disa javësh.

Sekretari i Mbrojtjes i ShBA-së, Pete Hegseth, zbuloi shqyrtimin gjashtëmujor në qershor dhe kërcënoi të mbajë disa detyrime të ShBA-së ndaj NATO-s nëse aleatët nuk do t'i përmbushnin angazhimet e shpenzimeve të mbrojtjes. Ai nuk tha në mënyrë të qartë se shqyrtimi mund të çonte në shkurtime të 80 000 trupave amerikane të vendosura në Evropë, por theksoi qëllimin e nxitjes së kontinentit të bëjë më shumë, duke i mundësuar ushtrisë amerikane t'i përmbushë angazhimet globale.



"Ne presim ndryshime në nivelet e trupave, por nuk dimë asgjë konkrete ende", tha Pistorius përpara një takimi me homologët e tij të BE-së në Bruksel, me të cilin Colby do të bashkohet për një drekë pune. "Por përsëri, një ndryshim në balancën e forcave konvencionale do të kishte ndodhur nën çdo president tjetër të ShBA-së, për shkak të rritjes së angazhimit në Indo-Paqësor".

Gjermania strehon rreth 35 000 trupa amerikane, prania më e madhe ushtarake amerikane në Evropë. Dhe siç bëhet me dije më tej, rezultati i shqyrtimit pritet të paraqitet para Krishtlindjeve.

Burime ushtarake evropiane kanë spekuluar se Uashingtoni mund të zhvendosë një brigadë ose rreth 5 000 trupa nga Gjermania ose në Azi ose më afër krahut lindor të NATO-s në Poloni.

Pistorius tha se bisedimet aktuale synojnë koordinimin me Uashingtonin për t'i parandaluar boshllëqet e rrezikshme për mbrojtjen evropiane të NATO-s të shkaktuara nga çdo tërheqje e ShBA-së.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

SAMITI BE - BALLKANI PERËNDIMOR: KOSOVËS DHE SERBISË PRITET T'U KËRKOHET PËRPARIM NË DIALOG



PRISHTINË, 17 NËNTOR - Udhëheqësit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) do ta shfrytëzojnë samitin e ardhshëm BE - Ballkani Perëndimor për të paralajmëruar se mungesa e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit vazhdon t'i pengojë të dyja palët në rrugën drejt integrimit evropian.

Krerët e shteteve dhe qeverive të BE-së do të theksojnë se duhet të zbatohen të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës, të ndërmjetësuar nga BE-ja, thuhet në draft-deklaratën të cilën e ka parë Radio Evropa e Lirë (REL).

Dokumenti pritet të miratohet në përfundim të samitit që pritet të mbahet më 25 nëntor në Bruksel. "Mbështetja në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor [Plani i Rritjes] kushtëzohet me angazhimin konstruktiv të partnerëve, përparimin e matshëm dhe rezultatet konkrete në normalizimin e marrëdhënieve të tyre", thuhet në draft-dokument.

Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ka vite që ka ngecur dhe udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë nuk janë takuar që nga shtatori i vitit 2023.

Shefja e diplomacisë evropiane, Kaja Kallas, e cila e mori detyrën në dhjetor të vitit 2024, nuk ka organizuar asnjë takim të nivelit të lartë.

Fillimisht si arsye për mungesën e takimeve përmendej gjendja e brendshme politike në të dyja vendet. Në Kosovë kriza institucionale zgjati gati dy vjet, ndërkaq Serbia u përball me protesta në mbarë vendin pas shembjes së strehës së hyrjes në stacionin hekurudhor të Novi Sadit, ku humbën jetën 16 persona.

Pas stabilizimit të institucioneve në Kosovë dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Serbi, të cilat i fitoi Lista e Studentëve, BE-ja do të përpiqet ta ringjallë dialogun pas formimit të qeverisë së re serbe.

Pritet të përsëritet dënimi i glorifikimit të kriminelëve të luftës

Samiti i udhëheqësve të shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor është caktuar për 25 nëntor. Deklarata miratohet nga udhëheqësit e BE-së, ndërsa pjesëmarrësit nga rajoni pajtohen me të.

Ndër të tjera, do të përsëritet se vendet e rajonit duhet t'i respektojnë vlerat dhe parimet evropiane. Udhëheqësit e BE-së do të ritheksojnë se presin që vendet e rajonit t'i dëshmojnë këto vlera edhe me vepra, veçanërisht kur bëhet fjalë për krimet e kryera gjatë luftërave të viteve '90. "Çdo glorifikim i kriminelëve të luftës, mohim i gjenocidit dhe revizionizëm janë në kundërshtim me vlerat më themelore evropiane", pritet të thuhet në deklaratën përfundimtare. Vendet e rajonit do të ftohen të promovojnë një kulturë respekti dhe solidariteti me të gjitha viktimat, si dhe respektimin e aktgjykimeve të gjykatave ndërkombëtare dhe vendore për krime lufte.

Në deklaratë pritet të thuhet se bashkëpunimi gjithëpërfshirës rajonal, pajtimi dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, mbeten thelbësore për ndërtimin e një të ardhmeje të përbashkët. E njëjta vlen edhe për zbatimin me mirëbesim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe arritjen e rezultateve konkrete.

Sipas draft-dokumentit, nevojiten ende përpjekje shtesë dhe vendimtare për ta nxitur pajtimin dhe stabilitetin rajonal. Ato nevojiten edhe për të gjetur dhe zbatuar zgjidhje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe detyruese për mosmarrëveshjet rajonale dhe dypalëshe që burojnë nga trashëgimia e së kaluarës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Ndër çështjet e përmendura janë Marrëveshja për Çështjet e Pasardhësisë, rastet e pazgjidhura të personave të zhdukur dhe krimet e luftës.

Një paragraf i veçantë i deklaratës i kushtohet përafrimit të vendeve të rajonit me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së, përfshirë zbatimin e sanksioneve dhe parandalimin e shmangies së tyre. Udhëheqësit e BE-së do t'i përgëzojnë partnerët që janë përafruar plotësisht me këtë politikë, ndërsa të tjerët do t'i ftojnë ta ndjekin shembullin e tyre.

Ky mund të jetë samiti i fundit për Malin e Zi si vend kandidat

Samiti mbahet rreth gjashtë muaj pas samitit në Tivat të Malit të Zi, vendi që konsiderohet kandidati më i mundshëm për t'u bërë anëtari i ardhshëm i BE-së.

Ky me shumë gjasë do të jetë samiti i fundit BE - Ballkani Perëndimor në të cilin Mali i Zi merr pjesë si vend kandidat.

Mali i Zi po punon bujshëm për mbylljen e të gjithë kapitujve të negociatave dhe pritet t'i përfundojë negociatat për anëtarësim deri në fund të këtij viti. Nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit pritet jo më herët se në qershor të vitit të ardhshëm. Në atë moment, Mali i Zi do të marrë statusin e vendit aderues.

Në përfundim të samitit të javës së ardhshme, udhëheqësit evropianë do të konfirmojnë se situata gjithnjë e më e paqëndrueshme gjeopolitike e thekson nevojën për unitet ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Kjo situatë karakterizohet nga lufta agresore e Rusisë kundër Ukrainës, konfliktet në Lindjen e Mesme dhe konkurrenca gjithnjë e më e ashpër globale. "Ritheksojmë përkushtimin tonë të plotë dhe të palëkundur ndaj perspektivës së anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin tonë. Zgjerimi është një mundësi reale që duhet shfrytëzuar", pritet të deklarojnë udhëheqësit evropianë në deklaratën përfundimtare.

Në dokument zgjerimi përshkruhet si një investim gjeostrategjik në paqen, sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin evropian. Vendet e rajonit do të ftohen t'i përshpejtojnë reformat vendimtare dhe t'i përmbushin detyrimet e nevojshme për përparimin drejt BE-së. Në të njëjtën kohë do të theksohet se edhe BE-ja duhet t'i avancojë përgatitjet dhe reformat e veta për një bllok të zgjeruar.

Presidentja takon ambasadorin japonez, kërkon thellim të bashkëpunimit dhe lehtësim të udhëtimit pa viza

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka Pula, priti në takim ambasadorin e Japonisë në Kosovë, Kiminori Iwama, bashkë me delegacionin e tij, me të cilin diskutoi për marrëdhëniet bilaterale dhe mundësitë e thellimit të mëtejmë të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve.

Presidentja Shiroka Pula shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Japonisë ndaj Kosovës, që nga njohja e pavarësisë e deri te përkrahja në zhvillimin e vendit dhe në përpjekjet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Ajo vlerësoi bashkëpunimin në fushat e ekonomisë, arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe rëndësinë e programeve të bursave MEXT për studentët e Kosovës. Gjithashtu, theksoi nevojën për avancimin e bashkëpunimit ekonomik përmes marrëveshjeve për mbrojtjen e investimeve dhe eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Presidentja theksoi nevojën që bashkëpunimi me Japoninë të thellohet edhe në lehtësimin e udhëtimit pa viza për qytetarët e Kosovës dhe në mbështetjen e aspiratave për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Ajo vlerësoi rolin e Japonisë në forcimin e stabilitetit dhe prosperitetit të rajonit.





GJYKATA SPECIALE I KA DËNUAR ME 41 MUAJ BURGIM THAÇIN, SMAKAJN DHE FAZLIUN, NDËRSA KUÇIN ME NJË MUAJ BURGIM ME KUSHT, PËR VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PENGIMIN E DREJTËSISË

KJO ËSHTË POLITIKË, JO DREJTËSI

Hashim Thaçi është dënuar nga Gjykata Speciale me 17 muaj burgim për vepra penale që lidhen me pengimin e drejtësisë, përfshirë tentativën për pengimin e personave zyrtarë, shkeljen e fshehtësisë së procedurës dhe mosbindjen ndaj gjykatës. Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu janë dënuar me nga 12 muaj burgim, ndërsa Hajredin Kuçi me një muaj burgim me kusht. Isni Kilaj është shpallur i pafajshëm. Smakaj dhe Fazliu janë liruar, pasi dënimin e kanë vuajtur përmes kohës së kaluar në paraburgim. Pas shpalljes së aktgjykimit ka reaguar ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ai është ngritur në këmbë dhe ka thënë: "Kjo është politikë, jo drejtësi"

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, u dënua me 17 muaj burgim në rastin për pengim të drejtësisë në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, më 17 nëntor. Ai u shpall fajtor për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe mosbindje ndaj gjykatës.

Gjykata konstatoi se Thaçi kishte zbuluar informacione konfidenciale për dëshmitarë gjatë vizitave që kishte pranuar në paraburgim në vitin 2023. Sipas aktgjykimit, ai i kishte përdorur vizitorët për t'u përcjellë disa dëshmitarëve udhëzime se si të dëshmonin në procesin e tij për krime lufte.

Pas shpalljes së aktgjykimit, ka reaguar ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ai është ngritur në këmbë dhe ka thënë: "Kjo është politikë, jo drejtësi".

Fadil Fazliu dhe Bashkim Smakaj u dënuan me nga 12 muaj burgim.

Gjykata konstatoi se Fazliu i kishte përcjellë dëshmitarit Rrustem Mustafa udhëzime të Thaçit, ndërsa Smakaj kishte marrë udhëzime me shkrim për dëshminë e Bislim Zyrapit dhe ishte takuar me të. Të dy u shpallën fajtorë për tentativë për pengim të personave zyrtarë dhe ndihmë në mosbindje ndaj gjykatës. Dënimet e tyre u konsideruan të shlyera me kohën e kaluar në paraburgim.

Isni Kilaj u shpall i pafajshëm për të gjitha akuzat.

Gjykata konstatoi se Thaçi i kishte dhënë udhëzime lidhur me dëshminë e një dëshmitari të mbrojtur, por nuk u provua se Kilaj kishte ndërmarrë veprime për t'ia përcjellë ato. Edhe Thaçi u shpall i pafajshëm për tentativën për pengim të personave zyrtarë përmes veprimit të përbashkët me Kilajn. Megjithatë, ai u shpall fajtor për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe mosbindje ndaj gjykatës, pasi i kishte zbuluar Kilajt informacione konfidenciale për dëshmitarë.

Hajredin Kuçi u dënua me një muaj burgim me kusht, me periudhë prove prej një viti, për mosbindje ndaj gjykatës.

Gjykata konstatoi se ai i kishte dërguar një mesazh dëshmitarit Rrustem Mustafa në kundërshtim me urdhrin që ndalonte kontakte të tilla.

Kuçi dhe Thaçi u shpallën të pafajshëm lidhur me një marrëveshje të pretenduar për kontaktimin e tre dëshmitarëve, pasi nuk u gjetën prova të mjaftueshme.

Nuk dihet saktë nëse dënimi prej 17 muajsh burgim ndaj Thaçit do të vihet veçmas nga dënimi i parë prej 25 vjetësh burgim, i shqiptuar më 16 shtator, apo nëse do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim. Më 5 dhjetor 2024 Thaçit iu dorëzua urdhërarresti për këtë çështje, ndonëse ai tashmë ndodhej në paraburgim në Hagë. Kjo do të thotë se deri më 17 nëntor 2026 kanë kaluar 23 muaj e 12 ditë nga ekzekutimi i urdhërarrestit të dytë. Të dy aktgjykimet janë të shkallës së parë dhe mund të apelohen.

Gjykata theksoi se pengimi i detyrave zyrtare gjatë një procesi gjyqësor përbën sulm ndaj integritetit të sistemit të drejtësisë.

Prokurorja e specializuar, Kimberly West, e mirëpriti aktgjykimin dhe tha të vazhdojë hetimet dhe ndjekjet penale për pengim të drejtësisë.

Ky aktgjykim nxiti reagime politike në Kosovë.

Ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, e cilësoi vendimin "të turpshëm" dhe "të papranueshëm", duke paralajmëruar veprime politike, juridike dhe diplomatike. "E turpshme! E papranueshme! Nuk ka asgjë më shqetësuese për drejtësinë sesa kur vendimet e saj pushojnë së befasuari, sepse besimi në paanshmërinë e saj është cenuar thellë. Shpreh zhgënjimin dhe shqetësimin tim të thellë për vendimin e sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Presidentit Hashim Thaçi dhe të tjerëve, në procesin për pengim të drejtësisë. Kontestimet procedurale, proceset e njëpasnjëshme dhe zvarritjet shumëvjeçare i kanë thelluar pikëpyetjet tona serioze për administrimin e drejtësisë të kësaj Gjykate. Drejtësia nuk mund të ketë dy standarde: një për ata që gjykohen dhe një tjetër për ata që gjykojnë. Padrejtësisë do t'i përgjigjemi ashtu siç e meriton: me qëndresë, mobilizim dhe përkushtim të palëkundur shtetëror e mbarëkombëtar. Me veprime konkrete politike, juridike e diplomatike. Me vendosmëri, deri në fund! Lufta jonë për liri ishte e drejtë. UÇK ishte ushtria jonë çlirimtare. Sakrifica e një populli për çlirim është pjesë e pandryshueshme e historisë sonë dhe nuk mund të njolloset - asnjëherë. Me çlirimtarët, deri në liri!", ka thënë Çitaku.

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK) e ka cilësuar "të pritshëm, por të papranueshëm" aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi dhe të tjerëve, në rastin për pengim të drejtësisë. Në një reagim në "Facebook", organizata e akuzoi Gjykatën se po ndjek një agjendë politike, duke pretenduar se vendimet e saj u shërbejnë

→



interesave të Serbisë dhe aleatëve të saj. "Kjo gjykatë, edhe një herë, dëshmoi se nuk po arrin të shkëputet nga agjenda politike që e ka shoqëruar që nga themelimi i saj", thuhet në reagim.
OVL-UÇK-ja paralajmëroi se do të vazhdojë t'i kundërshtojë vendimet që i konsideron të padrejta dhe përpjekjet që, sipas saj, synojnë njollosjen e luftës së UÇK-së.

Cakolli ngre pikëpyetje për llogaritjen e paraburgimit në dënimin e ri të Thaçit

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ngriti pikëpyetje për mënyrën se si do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga Hashim Thaçi, pas dënimit të tij me 17 muaj burgim për pengim të drejtësisë. Në "Facebook", Cakolli theksoi se Gjykata Speciale vendosi që dënimi i ri të vihet veçmas nga ai prej 25 vjetësh për krime lufte. Sipas tij, nëse të dyja aktgjykimet mbeten në fuqi, dënimi i përgjithshëm i Thaçit do të arrijë në 26 vjet e pesë muaj burgim. "Me aktgjykimin e sotëm, Hashim Thaçit iu shqiptuan edhe 17 muaj burgim për pengim të drejtësisë. Gjykatësi vendosi që ky dënim të vuhet VEÇMAS nga ai prej 25 vjetësh në rastin kryesor, që do të thotë se, nëse të dy aktgjykimet mbeten në fuqi, dënimi i përgjithshëm për Thaçin do të jetë plot 26 vjet e 5 muaj burgim", ka shkruar Cakolli.
Megjithatë, ai vuri në dukje se Thaçi është subjekt i një urdhërarresti të veçantë për rastin e pengimit të drejtësisë që nga 5 dhjetori 2024, pra prej më shumë se 23 muajsh, ndërsa dënimi i shqiptuar është 17 muaj. Cakolli tha se, ndryshe nga dy të dënuarit e tjerë në këtë rast - Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu - të cilëve iu llogarit koha e paraburgimit, në rastin e Thaçit "u vendos që dënimi të jetë shtesë, pa sqaruar qartë se si do të llogaritet periudha e kaluar në paraburgim nën urdhërarrestin e dytë".
Sipas tij, rregullat e Gjykatës parashohin zbritjen e kohës së paraburgimit nga dënimi, ndërsa mbetet e paqartë se si do të zbatohet ky parim në rastin e Thaçit.

Gruda: Fjalia e presidentit përshkruan më së miri vendimin e sotëm të Speciales, Kosova të veprojë

Deputeti i PDK-së, Përparim Gruda, ka reaguar ndaj vendimit të Gjykatës Speciale për ish-presidentin Hashim Thaçi. Ai e ka komentuar edhe deklarimin e Thaçit se dënimi i sotëm nuk është drejtësi. Në "Facebook", Gruda ka shkruar se fjalia e presidentit përshkruan më së miri vendimin e sotëm të Gjykatës Speciale. "'Kjo është politikë, nuk është drejtësi'. Kjo fjali e presidentit Hashim Thaçi e përshkruan më së miri vendimin e sotëm të Gjykatës Speciale. Kosova duhet të veprojë dhe ta mbrojë luftën e drejtë të popullit të saj për liri", ka shkruar Gruda.

Limaj: Kosova nuk mund të mbetet vetëm spektatore, institucionet tona duhet ta marrin përgjegjësinë që u takon

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka reaguar ndaj vendimit të Gjykatës Speciale për Hashim Thaçin. Ai ka thënë se edhe një padrejtësi, edhe një arsye më shumë për ta ngritur seriozisht çështjen e drejtësisë që po administrohet në emër të Kosovës. "Drejtësia nuk është vetëm shpallja e një aktgjykimi. Ajo kërkon paanshmëri, integritet, barazi të palëve dhe zbatim të standardeve të njëjta për të gjithë. Çdo proces gjyqësor duhet të garantojë të drejtën e mbrojtjes, shqyrtimin e paanshëm të provave dhe respektimin e plotë të standardeve të një gjykimi të drejtë. Pikërisht për këtë, shqetësimet për mënyrën se si po zhvillohen këto procese nuk mund të anashkalohen. Kosova nuk mund të mbetet vetëm spektatore. Institucionet tona duhet të marrin përgjegjësinë që u takon. Kuvendi duhet të veprojë, ligji duhet të rikthehet në fuqi dhe duhet të hapet një debat serioz për të ardhmen dhe mandatin e kësaj Gjykate. Kosova ka nevojë për drejtësi të vërtetë, për dinjitet dhe për institucione që mbrojnë interesin e shtetit të tyre", ka shkruar Limaj në "Facebook".

Paralajmërohen protesta nëse institucionet vazhdojnë të heshtin për krerët e UÇK-së

Iniciativa qytetare "Liria ka Emër" ka zhvilluar të martën një aksion simbolik para Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, pas shpalljes së aktgjykimit ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Gjatë aksionit Çlirim Haziri nga iniciativa qytetare "Jo në emrin tim", ka paralajmëruar protesta nëse institucionet vazhdojnë të heshtin përballë shqetësimeve lidhur me procesin gjyqësor ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).
Haziri i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesve të tij në Kosovë që të reagojnë ndaj shqetësimeve të ngritura për mënyrën e zhvillimit të procesit gjyqësor në Hagë. "Ne nuk kërkojmë trajtim të privilegjuar për Thaçin dhe të tjerët. Kërkojmë atë që i takon çdo njeriu, drejtësi të paanshme dhe respektim të dinjitetit njerëzor", ka deklaruar Haziri.
Ai ka kërkuar që institucionet dhe përfaqësuesit evropianë të mos i injorojnë shqetësimet e ngritura, duke insistuar në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
Në kuadër të aksionit, para objektit të BE-së është vendosur një pankartë me mbishkrimin "Evropë, ku është drejtësia?", përmes së cilës organizatorët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre ndaj drejtësisë ndërkombëtare.

Çfarë shkruajnë mediet ndërkombëtare për dënimin e Thaçit?

Dënimi i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, me 17 muaj burgim në rastin për pengim të drejtësisë në Hagë, është pasqyruar nga disa media ndërkombëtare, përfshirë "Associated Press", gazetën gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung" dhe agjencinë turke "Anadolu".
Agjencia amerikane "Associated Press" ka raportuar për deklaratën e Thaçit se vendimi ishte politik dhe jo drejtësi. Gazeta gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung" (FAZ) ka theksuar se gjykata i ka vërtetuar disa, por jo të gjitha akuzat ndaj Thaçit. Ajo ka vënë në dukje se Prokuroria kishte kërkuar gjashtë vjet burgim, ndërsa gjykata shqiptoi dënim prej 17 muajsh.
FAZ ka rikujtuar gjithashtu se ky është aktgjykimi i dytë i shkallës së parë ndaj Thaçit brenda dy muajsh, pas dënimit me 25 vjet burgim për krime lufte, më 16 shtator.
Ndërkaq, agjencia "Anadolu" ka raportuar për dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve dhe konstatimet e gjykatës lidhur me përpjekjet për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në procesin për krime lufte.



Aleanca kërkon nga Kryesia e Kuvendit kthimin prapa të rekomandimit për shkarkimin e anëtarëve të KPMShCK-së



Prishtinë, 17 nëntor - Aleanca, përmes deputetes Albana Bytyqi, në cilësinë e nënkryetares së parë të Komisionit për Administratë Publike, ka reaguar ndaj nismës së Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Përmes këtij reagimi është kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që sot ta kthejë mbrapsht rekomandimin e Komisionit, duke e cilësuar procesin të paarsyetuar dhe në kundërshtim me procedurat parlamentare.

"Është skandaloze që Vetëvendosja, me votat e veta në Komision, kërkon dhe rekomandon shkarkimin e anëtarëve të një institucioni të pavarur, pa arsyetim dhe pa respektuar procedurat parlamentare. Kjo nuk është reformë, por tentativë për kapje politike të institucioneve të pavarura dhe të administratës shtetërore", ka deklaruar deputetja Bytyqi.

Aleanca rikujton se institucionet e shtetit nuk janë pronë e asnjë partie dhe kërkon që të ndalet kapja e shtetit.

INSPEKTIMI GJEN SE QPS-ja NË PEJË NEGLIZHOI RASTIN E ARLINDA ZEKAJT, REKOMANDOHEN MASA DISIPLINORE



Prishtinë, 17 nëntor - Qendra për Punë Sociale në Pejë nuk i kishte përmbushur disa nga detyrimet gjatë trajtimit të rastit të Arlinda Zekajt, e cila u vra më 25 tetor në Vitomiricë të Pejës, thuhet në raportin e inspektimit të Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, të publikuar më 14 nëntor.

Zekaj, 49 vjeçe, dyshohet se u vra nga ish-kunati i saj, vetëm tri ditë pasi i ishte drejtuar kryeprokurores së Pejës, duke paralajmëruar se kishte frikë për jetën e saj dhe duke kërkuar ndërhyrjen e institucioneve.

Më 25 tetor, disa orë para se të vritej, ajo e kishte raportuar sërish dhunën në familje, pas së cilës bashkëshorti ishte ndaluar për 48 orë dhe Zekaj ishte kthyer në shtëpinë e saj, aty ku u vra.

Për shkak se kishte lënë si dëshmi të gjitha ankesat dhe kërkesat e saj ndaj institucioneve për mbrojtje, vrasja e Zekajt ka nxitur disa suspendime dhe hetime për neglizhimin e rastit të saj.

Sipas raportit të publikuar sot, Qendra për Punë Sociale nuk e kishte respektuar afatin gjyqësor për dorëzimin e një raporti, nuk kishte realizuar monitorimin e kërkuar dhe kishte dështuar në zbatimin e procedurave standarde për menaxhimin e rastit.

Raporti konstaton se një dokument i kërkuar nga Gjykata ishte dorëzuar jashtë afatit shtatëditor, dhe menaxherja e rastit, T. G., nuk kishte marrë pjesë në një seancë gjyqësore, pa dhënë arsye për mungesën.

Në mesin e mangësive të tjera u listuan mosplotësimi i formularëve për kontaktet dhe punën në rast, moshartimi i Planit Individual të Shërbimeve dhe mungesa e mbikëqyrjes së punës së menaxheres së rastit nga udhëheqësi i Shërbimeve Sociale, D. K.

Për këto shkelje, Divizioni i Inspektimit i ka rekomanduar kryetarit të komunës së Pejës të ndërmarrë masa disiplinore ndaj menaxheres së rastit dhe udhëheqësit të shërbimeve sociale në komunë.

Raporti kërkon edhe shtimin e stafit profesional në QPS-në e Pejës, duke vlerësuar se numri aktual i punonjësve është i pamjaftueshëm për numrin e rasteve dhe territorin që mbulon kjo qendër.

QPS-ja thotë se kishte ndërmarrë një sërë veprimesh

Në anën tjetër, Qendra për Punë Sociale në Pejë insistoi se gjatë trajtimit të rastit të Arlinda Zekajt kishte ndërmarrë një sërë veprimesh profesionale, përfshirë vizita në terren, vlerësime të rrethanave familjare dhe bashkëpunim me institucionet arsimore e shëndetësore.

Në një komunikatë të publikuar të shtunën, QPS-ja tha se kishte reaguar ndaj kërkesës së Policisë së Pejës duke angazhuar punonjësin social në kuadër të kujdestarisë 24-orëshe. Gjatë trajtimit të rastit, sipas saj, ishin realizuar biseda me prindërit dhe familjarët, si dhe ishin mbledhur informacione për gjendjen familjare dhe socio-ekonomike.

Sa iu përket procedurave gjyqësore, QPS-ja pretendon se kishte marrë pjesë në seancat pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kishte dorëzuar raporte profesionale dhe kishte paraqitur vlerësimet e Organit të Kujdestarisë për gjendjen dhe nevojat e fëmijës.

Pas vrasjes së Arlindës, Qendra tha se kishte ndërmarrë veprime urgjente për vendosjen e fëmijës në një mjedis të sigurt, në bashkëpunim me Policinë, Prokurorinë dhe institucionet përkatëse. Ajo tha se ishte siguruar edhe caktimi i kujdestarit ligjor.

Megjithatë, Qendra tha se i merr seriozisht rekomandimet e inspektimit, të cilat i cilësoi si çështje që kërkojnë përmirësim në aspektin administrativ, organizativ dhe procedural.

Ajo përmendi edhe nevojën për shtimin e stafit profesional dhe qartësimin e përgjegjësive ndërmjet QPS-së dhe Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

Zekaj kërkoi ndihmë tri ditë para se të vritej

Arlinda Zekaj kishte kërkuar mbrojtje nga institucionet, duke paralajmëruar se kishte frikë për jetën e saj.

Më 22 tetor, tri ditë para vrasjes, ajo i ishte drejtuar kryeprokurores së Pejës, Lumturije Vuçetaj, duke ngritur shqetësime për mosveprimin e institucioneve dhe moszbatimin e vendimit gjyqësor.

Një ditë më vonë, më 23 tetor, një hetues policor kishte kërkuar nga drejtuesit e Policisë në Pejë që Arlinda të vizitohej çdo ditë nga patrullat policore dhe të mbahej komunikim i rregullt me të, pasi situata në shtëpinë ku ajo ndodhej vazhdonte të ishte e tensionuar.

Më 25 tetor ajo u vra në Vitomiricë. Për vrasjen dyshohet kunati i saj, Albert Sylaj, i cili është arrestuar dhe ndodhet në paraburgim. Pas vrasjes, institucionet nisën hetime për veprimet dhe mosveprimet e zyrtarëve që ishin marrë me rastin.

Më 29 tetor, Policia e Kosovës njoftoi suspendimin e 11 zyrtarëve policorë, pas rekomandimit të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Ndërkaq, më 30 tetor, Ministria e Drejtësisë publikoi gjetjet paraprake për veprimet dhe mosveprimet institucionale në këtë rast, ku ishin evidentuar edhe mangësi në punën e QPS-së në Pejë.

Pas vrasjes së saj, edhe Kuvendi i Kosovës ka formuar edhe një komision hetimor parlamentar, me mandat për të shqyrtuar veprimet dhe mosveprimet e institucioneve përgjegjëse në trajtimin e rastit të Arlinda Zekajt.

Fejzullah Krasniqi zgjedhet kryetar i AShAK-ut



Prishtinë, 17 nëntor - Akademik Fejzullah Krasniqi është zgjedhur kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (AShAK).

Zgjedhja e tij është bërë të martën në mbledhjen e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ku në rend dite ishte zgjedhja e kryetarit të ri të institucionit. Lajmin e ka publikuar Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

LIMAJ KËRKON RIKTHIMIN NË KUVEND TË LIGJIT PËR PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

Faton DËRMAKU

FERIZAJ, 17 NËNTOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka kërkuar që ligji që trajton procesin gjyqësor në Hagë të rikthehet sa më parë në Kuvend dhe të votohet pa vonesa të mëtejshme. Këtë kërkesë Limaj e ka bërë gjatë një bashkëbisedimi me qytetarë në Ferizaj, të organizuar me ftesë të Rrjetit të OJQ-ve AVONET, me temën "Kosova pas 16 shtatorit".

Limaj ka thënë se kjo temë nuk i përket vetëm së kaluarës sonë, por prek drejtpërdrejt të tashmen dhe të ardhmen e shtetit tonë. "Në këtë diskutim nuk fola vetëm si përfaqësues politik, por edhe si njeri që e ka përjetuar drejtpërdrejt përballjen me drejtësinë ndërkombëtare. Kam qenë ndër të parët që jam përballur me mekanizmat gjyqësorë ndërkombëtarë për krimet e luftës në ish-Jugosllavi, fillimisht përmes Tribunalit të Hagës dhe më pas përmes misioneve ndërkombëtare të drejtësisë në Kosovë. Pikërisht për këtë arsye, e di nga përvoja se çfarë nënkupton përballja me një proces të tillë, sa e rëndësishme është drejtësia dhe sa të domosdoshme janë respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe garantimi i një gjykimi të drejtë", ka thënë Limaj.

Ai gjatë bashkëbisedimit ka shprehur shqetësimet e tij lidhur me procesin gjyqësor në Hagë. "Mungesa e transparencës, pikëpyetjet mbi kredibilitetin e trupit gjykues, kontestimet lidhur me vlefshmërinë e provave dhe çështjet që lidhen me të drejtat procedurale të të akuzuarve janë shqetësime që meritojnë vëmendje serioze. Republika e Kosovës nuk duhet të qëndrojë pasive përballë kësaj çështjeje. Institucionet tona kanë përgjegjësi që të veprojnë me vendosmëri dhe në përputhje me obligimet e tyre kushtetuese e ligjore. Prandaj, kërkesa ime është e qartë: Ligji që trajton procesin gjyqësor në Hagë duhet të rikthehet sa më parë në Kuvend dhe të votohet pa vonesa të mëtejshme. Nuk ka arsye që kjo çështje të mbetet peng i zvarritjeve institucionale. Mbrojtja e të drejtave të të akuzuarve, respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe garantimi i një gjykimi të drejtë kërkojnë veprim konkret", është shprehur Limaj, duke shtuar se këtë angazhim duhet ta zhvillojmë me argumente juridike, me dokumente dhe me komunikim të vazhdueshëm me



aleatët tanë strategjikë.

Limaj ka ngritur edhe një shqetësim tjetër që lidhet me disproporcionin e madh në dënimet e shqiptuara. "Sipas shifrave të prezantuara në diskutim, për krimet e kryera nga Serbia në Kosovë janë shqiptuar gjithsej 106 vjet burgim, ndërsa ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë shqiptuar 567 vjet burgim. Ndërkohë, shumë krime të kryera gjatë luftës në Kosovë vazhdojnë të kërkojnë drejtësi. Masakrat në Qirez, Poklek dhe Abri, si dhe krimet e shumta të vitit 1999, varrezat masive dhe zhvendosja e fshehtë e trupave të viktimave shqiptare nga strukturat shtetërore serbe, janë pjesë e një historie që nuk duhet të lihet në harresë", ka thënë ai.

Në bashkëbisedimin me qytetarët e Ferizajt, Limaj ka theksuar se kjo çështje nuk duhet të na ndajë sipas bindjeve politike apo përkatësisë brezore. "Përkundrazi, kërkon bashkim, përgjegjësi dhe angazhim të përbashkët kombëtar. Të rinjtë, institucionet, akademia, shoqëria civile dhe të gjithë qytetarët duhet të jenë pjesë e këtij debati. Mbrojtja e historisë sonë nuk është detyrë e një partie, e një individi apo e një gjenerate. Është përgjegjësi e të gjithë neve. Kosova ka nevojë për unitet, guxim dhe vendosmëri. Mbrojtja e së vërtetës historike, dinjitetit të luftës çlirimtare dhe të drejtave të atyre që po përballen me procesin në Hagë duhet të jetë një angazhim i përbashkët. Kosova pas 16 shtatorit kërkon reflektim, përgjegjësi dhe veprim institucional", ka deklaruar Limaj.

MINISTRI ÇEKU NISI NË PRISHTINË KONSULTIMET ME STUDENTËT PËR STRATEGJINË E ARSIMIT 2035+

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Hajrulla Çeku, nisi në Prishtinë ciklin e takimeve konsultative me studentët për hartimin e Strategjisë së Arsimit 2035+, me qëllim përfshirjen e pikëpamjeve, përvojave dhe rekomandimeve të tyre në përcaktimin e prioriteteve për zhvillimin e arsimit në Kosovë.

Në takim mori pjesë edhe kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit të Prishtinës, Flon Kastrati.

Në fjalën e tij, ministri Çeku theksoi se përparimi i arsimit kërkon angazhimin e përbashkët të institucioneve dhe të gjithë shoqërisë. Ai nënvizoi se pjesëmarrja e studentëve është thelbësore për hartimin e një strategjie që pasqyron



nevojat reale të arsimit të lartë dhe ofron zgjidhje për sfidat e tij. Ministri Çeku i ftoi studentët që, krahas kërkesave dhe shqetësimeve për kushtet e studimit, të kontribuojnë me ide dhe propozime konkrete për të ardhmen e universiteteve dhe përmirësimin e cilësisë së studimeve.

Në fokus të fjalës së tij ishte nevoja për ta shqyrtuar cilësinë dhe ofertën e programeve universitare, përgatitjen e të diplomuarve për jetën profesionale dhe përputhjen e njohurive e shkathtësive të fituara gjatë studimeve me kërkesat e tregut të punës.

Ministri theksoi se studimet duhet t'u shërbejnë të rinjve për punësim në profesion, pavarësi ekonomike dhe përmirësim të mirëqenies së tyre.

Për ta orientuar bashkëbisedimin, ministri Çeku i ftoi studentët t'i ndajnë përvojat e tyre lidhur me përgatitjen që ofrojnë studimet për jetën profesionale, mjetet e nevojshme për të mësuar dhe mundësitë për hulumtim.

Ai kërkoi të dëgjojë për pengesat që hasin në ndjekjen dhe përfundimin e studimeve, përvojën e tyre të përditshme në universitet dhe fakultet, si dhe nëse zëri i tyre dëgjohet mjaftueshëm dhe nëse kanë mundësi të barabarta për të ecur përpara.

Studentët u ftuan t'i ndajnë shqetësimet dhe rekomandimet e tyre për përmirësimin e përvojës universitare dhe zhvillimin e arsimit të lartë.

Takimi në Prishtinë pason konsultimet me mësimdhënësit, drejtuesit e universiteteve dhe prindërit.

Bashkëbisedimet me studentët do të vijojnë në Gjilan dhe në rajonet e tjera të Kosovës, në funksion të hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse për arsimin.

Komisioni parlamentar pret ambasadorin britanik, diskutohet për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione i Kuvendit të Kosovës ka pritur në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves.

Takimi, i kryesuar nga kryetarja e Komisionit, Fatmire Kollçaku, ishte njoftues dhe miqësor, si takimi i parë i deputetëve të legjislaturës së re me ambasadorin britanik.

Gjatë takimit anëtarët e Komisionit paraqitën prioritetet kryesore për pjesën e mbetur të këtij viti si dhe objektivat dhe synimet për vitin e ardhshëm, duke u fokusuar në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Deputetët shprehën mirënjohjen për Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e vazhdueshme në të gjitha fazat e shtetndërtimit të Kosovës.

Ndërkaq, ambasadori Hargreaves i uroi Komisionit punë të mbarë dhe vlerësoi frymën e bashkëpunimit dhe konstruktivitetit në punën e tij.

Në përfundim të takimit të dyja palët u pajtuan për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.



Auditorët e ZKA-s marrin pjesë në punëtorinë e EUROSAI-t në Shkup

Prishtinë, 17 nëntor - Auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), Ganimete Dalloshi, Shpresa Zenelaj dhe Besim Lezi, morën pjesë në punëtorinë e 9-të të Grupit të Projektit të EUROSAI-t mbi Analizën e Mbështjelljes së të Dhënave (DEA) dhe Metodat e Tjera të Krahasimit të Performancës (Benchmarking), që u mbajt më 11 dhe 12 nëntor 2026 në Shkup të Maqedonisë së Veriut.

Punëtoria mblodhi përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit për të shkëmbyer përvoja dhe praktika lidhur me zbatimin e metodave të krahasimit në auditim.

Programi dyditor u përqendrua në konceptet e avancuara të metodës DEA dhe përdorimin e aplikacionit pioneeR, përmes sesioneve praktike, analizës dhe interpretimit të rezultateve, si dhe prezantimit të shembujve konkretë nga praktikat audituese.

Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu mbi mundësitë e zbatimit të këtyre metodave në procesin e auditimit dhe forcimin e bashkëpunimit profesional ndërmjet institucioneve anëtare të rrjetit EUROSAI DEA.

Punëtoria u organizua në kuadër të zbatimit të Qëllimit të Dytë Strategjik (SG2) të Planit Strategjik të EUROSAI-t 2024-2030, ndërsa nikoqire ishte Zyra Shtetërore e Auditimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut.



GAP: 87 PËR QIND E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË KOSOVËS KONTRIBUUAN NË OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Prishtinë, 17 nëntor - Instituti GAP ka paraqitur raportin "Përputhja e buxhetit të Kosovës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2021 - 2025)", sipas të cilit, rreth 87 për qind e shpenzimeve buxhetore të Kosovës gjatë kësaj periudhe kanë kontribuar në realizimin e këtyre objektivave.

Raporti është paraqitur në një tryezë diskutimi të organizuar nga Instituti GAP, ku janë analizuar shpenzimet buxhetore gjatë pesë vjetëve të fundit dhe shpërndarja e tyre në 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Drejtori ekzekutiv i Institutit GAP, Blendi Hasaj, tha se analiza është realizuar me mbështetjen e Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me qëllim të vlerësimit se sa përputhen shpenzimet publike me këto objektiva.

Hasaj theksoi se, ndonëse një pjesë e madhe e buxhetit kontribuon në realizimin e objektivave, shpenzimet janë të përqendruara kryesisht në tri ose katër fusha, ndërsa barazia gjinore dhe mbrojtja e mjedisit nuk reflektohen mjaftueshëm në ndarjet buxhetore. Ai vlerësoi se këto gjetje ngrenë nevojën për rishikimin e prioriteteve buxhetore, veçanërisht në një kohë kur ndryshimet klimatike dhe sfidat mjedisore kërkojnë më shumë vëmendje institucionale.



Ndërkaq, koordinatori i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë, Stephen O'Malley, tha se buxheti është pasqyra më e qartë e prioriteteve të një qeverie dhe shoqërie. Sipas tij, gjatë periudhës 2021-2025 rreth 13.4 miliardë euro, apo 87 për qind e shpenzimeve buxhetore, janë dedikuar për aktivitete që kanë kontribuar në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ai bëri me dije se pjesa më e madhe e këtyre mjeteve është orientuar drejt mbrojtjes sociale, institucioneve publike, sundimit të ligjit, infrastrukturës arsimore dhe shëndetësisë.

Megjithatë, O'Malley theksoi se shpenzimet janë të përqendruara, pasi pesë objektiva përfitojnë 82 për qind të mjeteve të dedikuara për këto qëllime, ndërsa gjashtë objektiva përfitojnë më pak se një për qind.

Në mesin e fushave që marrin më pak mbështetje buxhetore janë barazia gjinore, zvogëlimi i pabarazive, veprimi për klimën dhe mbrojtja e natyrës.

O'Malley vlerësoi se raporti paraqet përpjekjen e parë gjithëpërfshirëse për ta analizuar përputhjen e shpenzimeve buxhetore të Kosovës me zotimet për realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030.

ASK: KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË U RRIT PËR 10,74 PËR QIND NË SHTATOR



Prishtinë, 17 nëntor - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e energjisë për muajin shtator 2026 të cilat tregojnë rritje të konsumit dhe prodhimit të energjisë elektrike krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të ASK-së, konsumi i energjisë elektrike në shtator ishte 386.10 GWh, që paraqet rritje prej 10,74-përqindësh krahasuar me shtatorin e vitit 2025.

Ndërkaq, energjia elektrike bruto në dispozicion arriti në 467.69 GWh, me një rritje prej 4,42-përqindësh në raport me të njëjtin muaj të vitit paraprak.

Një rritje e theksuar është regjistruar edhe në prodhimin bruto të energjisë elektrike nga era dhe ajo solare, i cili arriti në 38.16 GWh, apo 96,23 për qind më shumë se në shtator të vitit 2025. Sipas ASK-së, pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në konsumin e përgjithshëm ishte 11,20 për qind.

Sa i përket tregtisë së energjisë elektrike, importi gjatë shtatorit ishte 308.37 GWh, ndërsa eksporti arriti në 274.23 GWh, ku përfshihet edhe sasia e transmisionit.

Ndërkohë, prodhimi i thëngjillit gjatë këtij muaji ishte 509.853 mijë tonë, duke shënuar rënie prej 1,12-përqindësh krahasuar me shtatorin e vitit të kaluar.

ASK ka bërë me dije se publikimi përfshin edhe të dhëna për prodhimin dhe konsumin e energjentëve të tjerë si dhe importin dhe eksportin e tyre.

Ministri Hoti takon përfaqësuesit e pensionistëve, diskuton për nevojat dhe kërkesat e tyre

Prishtinë, 17 nëntor - Ministri për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, ka pritur në takim përfaqësuesit e Lidhjes së Organizatave Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për nevojat, kërkesat dhe çështjet me interes për këto kategori.

Gjatë takimit, Hoti ka theksuar se Qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në avancimin e të drejtave të pensionistëve, përmes ndryshimeve ligjore, rritjes së pensionit bazik nga 90 në 150 euro dhe mbështetjes së vazhdueshme financiare.

Ai ka ritheksuar përkushtimin për reformimin e sistemit pensional, me synimin e përmirësimit të pozitës së pensionistëve dhe avancimit të të drejtave të tyre.



MEDUZA, BUKURIA E SHNDËRRUAR NË MALLKIM QË E KTHENTE BOTËN NË GUR

Nga rrëfimet e poetëve të lashtësisë te kryeveprat e Rilindjes, Meduza dhe historia e saj mbetet një nga tragjeditë më të fuqishme të mitologjisë, ku bukuria, dhuna, hakmarrja dhe pushteti i perëndive ndërthuren me fatin e një gruaje.

GORGONA QË LINDI NGA MITET E LASHTËSISË

Pak figura të mitologjisë kanë përshkuar historinë e njerëzimit me një fuqi simbolike të krahasueshme me atë të Meduzës. Gruaja me flokë prej gjarpërinjsh, vështrimi i së cilës shndërronte njerëzit në gur, shfaqet në rrëfimet e lashta shumë shekuj përpara lindjes së qytetërimit romak.

Një nga dëshmitë më të hershme letrare gjendet në veprën Teogonia të Hesiodit, të shkruar rreth shekullit VIII–VII para Krishtit. Poeti grek përshkruan tri motrat Gorgona, Stenon, Eurialën dhe Meduzën, bijat e hyjnive detare Forkisi dhe Keto. Ndryshe nga motrat e saj, të cilat ishin të pavdekshme, Meduza ishte e destinuar të vdiste.

Në traditën e hershme, ajo paraqitej si një krijesë e frikshme. Megjithatë, rrëfimi që do ta shndërronte Meduzën në një figurë thellësisht tragjike u përjetësua shekuj më vonë nga poeti romak Ovidi, në veprën e tij Metamorfozat, të përfunduar rreth vitit 8 pas Krishtit.

MEDUZA, BUKURIA QË TËRHOQI NJË PERËNDI

Sipas Ovidit, përpara se emri i saj të bëhej sinonim i tmerrit, Meduza ishte një vajzë me bukuri të jashtëzakonshme. Shumë burra dëshironin të fitonin zemrën e saj, ndërsa flokët përbënin tiparin më të admiruar të hijeshisë së saj.

Por në botën mitologjike të grekëve dhe romakëve, bukuria e një vdekatareje mund të tërhiqte vëmendjen e forcave që ajo nuk ishte në gjendje t'i kundërshtonte.

Fama e Meduzës arriti deri te Poseidoni, sundimtari i deteve, i njohur në mitologjinë romake me emrin Neptun. Perëndia, që zotëronte fuqinë e dallgëve dhe tërmeteve, u tërhoq nga bukuria e saj.

Vëmendja e një hyjnie, që për shumë njerëz mund të konsiderohej nder, për Meduzën do të shënonte fillimin e një tragjedie.

PËRDHUNIMI NË TEMPULLIN E ATHINASË

Ngjarja që ndryshoi përgjithmonë fatin e Meduzës ndodhi në tempullin e Athinasë, perëndeshës së urtësisë, luftës strategjike dhe zejtarisë.

Sipas rrëfimit të Ovidit, Poseidoni dhunoi Meduzën brenda hapësirës së shenjtë. Athinaja, e tmerruar nga përdhosja e tempullit të saj, largoi vështrimin dhe mbuloi fytyrën me egjidë.

Por zemërimi i perëndeshës nuk u drejtua kundër sundimtarit të deteve. Pasojat e ngjarjes do t'i përballonte vetë Meduza.

Kjo pjesë e mitit pasqyron një nga tiparet më të errëta të marrëdhënieve ndërmjet njerëzve dhe perëndive në letërsinë antike. Hyjnitë zotëronin një pushtet pothuajse të pakufishëm, ndërsa vdekatarët shpesh paguanin çmimin e përplasjeve dhe dëshirave të tyre. Pikërisht kjo padrejtësi e ka bërë historinë e Meduzës objekt interpretimesh të panumërta në epokën moderne.

METAMORFOZA, NGA BUKURIA NË TMERR

Dënimi i Athinasë preku atë që Meduza kishte më të admiruar: flokët e saj. Perëndesha i shndërroi në gjarpërinj të gjallë, duke i dhënë asaj pamjen që do të mbetej e skalitur në kujtesën e njerëzimit.

Në traditën mitologjike, vështrimi i Gorgonës kishte një fuqi shkatërrimtare. Kushdo që e shihte drejtpërdrejt në fytyrë, shndërrohej në gur.

Ajo që dikur kishte zgjuar dashuri dhe admirim, tashmë ngjallte frikë dhe tmerr.

Metamorfoza e Meduzës nuk përfaqësonte vetëm një ndryshim fizik. Në leximin tragjik të mitit, ajo nënkuptonte humbjen e mundësisë për të jetuar pranë të tjerëve. Një vështrim i zakonshëm, gjesti më njerëzor i komunikimit, ishte shndërruar në një armë vdekjeprurëse.

MBRETËRIA E HESHTJES DHE E GURIT

Autorët e lashtë e vendosnin banesën e Gorgonave në skajet e botës së njohur. Hesiodi i përshkruante ato përtej Oqeanit, pranë vendit ku jetonin Hesperidet.

Në imagjinatën mitologjike, kjo hapësirë përfaqësonte kufirin ndërmjet botës njerëzore dhe territoreve të sunduara nga qenie të mbinatyrshme.

Përreth strehës së Meduzës, sipas rrëfimit të Ovidit, gjendeshin njerëz dhe kafshë të shndërruara në gur. Çdo figurë ruante pamjen e një qenieje që kishte pasur fatin e keq të përballej me Gorgonën.

Meduza ishte bërë një krijesë së cilës të gjithë i druheshin, por që njëkohësisht mbetej e cenueshme. Ndryshe nga motrat e saj, ajo nuk gëzonte mbrojtjen e pavdekësisë.

ARDHJA E PERSEUT DHE MISIONI I PAMUNDUR

Ndërkohë, në ishullin grek të Serifit, po merrte udhë një histori që do të përcaktonte fundin e Meduzës. Perseu, biri i Zeusit



dhe Danaes, ishte rritur nën mbrojtjen e një peshkatari të quajtur Diktis.

Mbreti Polidekt, i cili dëshironte të martohej me Danaen, e shihte Perseun si pengesë për planet e tij. Për ta larguar, i ngarkoi një detyrë në dukje të pamundur: t'i sillte kokën e Meduzës.

Por Perseu nuk ishte vetëm. Athinaja dhe Hermesi e ndihmuan të siguronte mjetet e nevojshme për përballjen me Gorgonat. Një armë e mprehtë, sandalet me krahë, përkrenarja e padukshmërisë dhe një mburojë e lëmuar do t'i mundësonin të sfidonte fuqinë e Meduzës.

VËSHTRIMI NË PASQYRË

Kur mbërriti në strehën e Gorgonave, Perseu i gjeti ato të zhytura në gjumë. Duke ditur se një vështrim i drejtpërdrejtë do t'i kushtonte jetën, ai përdori sipërfaqen e shndritshme të mburojës për të parë pasqyrimin e Meduzës.

I udhëhequr nga Athinaja, heroi iu afrua Gorgonës dhe me një goditje ia ndau kokën nga trupi.

Meduza vdiq pa pasur mundësinë të shihte njeriun që i mori jetën.

Britmat e motrave të saj, të cilat u zgjuan dhe ndoqën vrasësin, nuk mundën ta ndalonin Perseun. I mbrojtur nga përkrenarja që e bënte të padukshëm, ai u largua duke marrë me vete kokën e Meduzës.

NGA VDEKJA LINDI NJË MREKULLI

Por vdekja e Meduzës nuk shënoi fundin e historisë së saj. Nga trupi i Gorgonës lindën dy qenie të jashtëzakonshme: Pegasi, kali me krahë, dhe Krisaori, luftëtari i lidhur me simbolikën e shpatës së artë.

Të dy konsideroheshin pasardhës të Poseidonit.

Pegasi do të bëhej një nga krijesat më të famshme të mitologjisë. Figura e tij do të lidhej me heroin Belerofon, ndërsa në shekujt e mëvonshëm do të simbolizonte frymëzimin poetik dhe lirinë.

Nga trupi i një qenieje së cilës bota i druhej kishte lindur një nga figurat më madhështore të imagjinatës antike.

FYTYRA QË NUK E HUMBI FUQINË

Edhe pas vdekjes, koka e Meduzës ruajti aftësinë për t'i shndërruar njerëzit në gur. Perseu e përdori atë kundër kundërshtarëve të tij, përfshirë mbretin Polidekt.

Pas përfundimit të aventurave, ai ia dorëzoi kokën Athinasë. Perëndesha e vendosi mbi egjidën e saj, duke e kthyer në një emblemë të fuqisë hyjnore.

Kështu, fytyra që dikur kishte qenë objekt dënimi u bë simbol i mbrojtjes së vetë perëndeshës që e kishte ndështkuar.

MEDUZA NË ARTIN E BOTËS ANTIKE

Në qytetërimin grek, figura e Meduzës nuk shërbente vetëm për të treguar një histori mitologjike. Koka e Gorgonës, e njohur me termin gorgoneion, zbukuronte tempuj, mburoja, monedha dhe enë qeramike.

Grekët besonin se pamja e saj e frikshme mund të largonte forcat keqdashëse. Për këtë arsye, ajo vendosej shpesh në ndërtesa dhe objekte me funksion mbrojtës.

Në periudhën arkaike, Meduza paraqitej me dhëmbë të mëdhenj, sy të zgurdulluar dhe gjuhë të nxjerrë. Me kalimin e shekujve, artistët filluan t'i jepnin tipare më njerëzore, duke e shndërruar gradualisht në një figurë ku bukuria bashkëjetonte me tmerrin.

NGA RILINDJA TE BOTA MODERNE

Magjepsja ndaj Meduzës nuk përfundoi me rënien e qytetërimit antik. Gjatë Rilindjes evropiane, artistët iu rikthyen historisë së saj.

Skulptori italian Benvenuto Çelini realizoi monumentin e famshëm prej bronzi të Perseut me kokën e Meduzës, të ekspozuar në Firence më 1554. Disa dekada më vonë, Karavaxho përjetësoi fytyrën e Gorgonës në një pikturë mbi mburojë, duke paraqitur tmerrin e çastit të fundit.

Në kohët moderne, Meduza është interpretuar gjithnjë e më shumë si simbol i gruas së dhunuar, padrejtësisë dhe qëndresës përballë pushtetit.

PËRTEJ PËRBINDËSHIT, TRAGJEDIA E NJË GRUAJE

Historia e Meduzës vazhdon të ngrejë pyetje që kapërcejnë kufijtë e mitologjisë. Kush ishte përbindëshi i vërtetë? Gruaja që mbante mallkimin apo hyjnitë që përcaktuan fatin e saj?

Për shekuj, ajo u kujtua si krijesa që duhej vrarë për të dëshmuar madhështinë e një heroi. Sot, shumë lexues shohin tek ajo një viktimë të pushtetit, dhunës dhe ndëshkimit të padrejtë.

Mes gjarpërinjve, vështrimit vdekjeprurës dhe bukurisë së humbur, Meduza mbetet një nga enigmat më magjepsëse të trashëgimisë antike.

Gruaja që askush nuk mund ta shihte në sy, u bë një nga fytyrat më të vështruara në historinë e njerëzimit. / bota.al

KREMLINI KËRCËNON EVROPËN DHE KËRKON NJË REND TË RI



Objektivi i Rusisë është i qartë: të rrisë tensionet me Europën, të krijojë konfuzion dhe nervozizëm, ndërkohë që amerikanët këmbëngulin që edhe europianët të ulen në tryezën e negociatave mes Moskës dhe Kievit. Pikërisht në këtë këndvështrim duhen interpretuar deklaratat e zëdhënësit të Kremlinit, Dmitri Peskov, për korrespondentin e Vesti, Pavel Zarubin.

Peskov e lidh zgjidhjen e konfliktit në Ukrainë me ripërcaktimin e arkitekturës së sigurisë në Europë. "Në një moment të caktuar do të na duhet ta diskutojmë këtë çështje me evropianët. Pyetja është nëse ata e dëshirojnë vërtet paqen. Nëse nuk e dëshirojnë, atëherë diskutime të tilla do të jenë të kota", deklaroi ai, duke shtuar se Rusia, "duke qenë se nuk ka hapësirë për negociata, do të duhet të veprojë me forcë".

Provokimet shoqërohen me akte sabotazhi që synojnë të destabilizojnë vendet europiane të cilat vazhdojnë të mbështesin Ukrainën. Estonia ka njoftuar se, duke filluar nga 1 dhjetori, do të mbyllë të gjitha pikat e kalimit kufitar me Rusinë, "pas sigurimit të provave të pakundërshtueshme se GRU-ja, shërbimi rus i inteligjencës ushtarake, ka urdhëruar një operacion sabotazhi kundër një kompanie estoneze të industrisë së mbrojtjes".

Kremlini dhe sabotazhet në Estoni

Tetë persona, të dyshuar se kanë tentuar t'i vënë zjarrin selisë së kompanisë prodhuese të dronëve Threod Systems, janë arrestuar në Estoni gjatë natës mes së premtes dhe së shtunës. Ministri i Jashtëm, Margus Tsahkna, shpjegoi se "Rusia duhet ta kuptojë se çdo akt armiqësor kundër Estonisë do të ketë pasoja" dhe se përpjekjet për të "frikësuar, destabilizuar apo cenuar" sigurinë e vendit baltik, anëtar i NATO-s, "nuk do të mbeten të pandëshkuara".

Deri më tani, Talini ka mbajtur të hapura tri pika kufitare me Rusinë për kalimin e këmbësorëve dhe të mallrave. Qarkullimi i automjeteve përmes pikës kufitare të Narvës u pezullua nga Moska në shkurt të vitit 2024. Finlanda e mbylli të gjithë kufirin tokësor me Rusinë në dhjetor të vitit 2023. Vazhdojnë të funksionojnë, ndonëse me kufizime, pikat kufitare të Letonisë me Rusinë, si dhe ato të Lituanisë dhe Polonisë me eksklavën e Kaliningradit.

Në Bruksel nuk habiten nga kërkesat maksimaliste të Rusisë, të cilat konsiderohen si pjesë e mënyrës së negocimit të Moskës: nisja e bisedimeve nga një pozicion tejet i ashpër, në shumë aspekte fyes. Ekziston vetëdija se këto kërkesa do t'i vënë në siklet shtetet anëtare. Tashmë është e qartë se nuk bëhet fjalë për negociata normale, por për një proces mjaft të paqëndrueshëm.

Komisioni Europian do të nisë të ashtuquajturat "rrëfime konfidenciale" për paketën e 22-të të sanksioneve kundër Moskës, pra takime dypalëshe me dyer të mbyllura me shtetet anëtare, gjatë të cilave do të diskutohet edhe kredia prej 45 miliardësh për Kievin, që do të prezantohet të mërkurën.

Mandati për negociatat

Një tjetër çështje qendrore është përcaktimi i mandatit negociues të formatit E7 – Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia, Polonia, Komisioni Europian dhe Këshilli Europian – përpara raundit të ardhshëm të negociatave. Ka gjasa që europianët të përqendrohen te rindërtimi, ndërsa arkitektura e sigurisë do të jetë kryesisht kompetencë e NATO-s.

Ndërkohë, dje Volodimir Zelenski i drejtoi një tjetër apel Musk-ut: "Të heqë kufizimet ndaj Starlink-ut dhe të qëndrojë në anën e duhur të historisë".

Bllofi që bën Putini: të shfrytëzojë përçarjet në Perëndim për një rend të ri

Riformësimi i Europës pa Europën. Nuk është thjesht titulli i një prej emisioneve të shumta televizive të fundjavës. Mund ta shtjellojmë sa të duam, por në fund të fundit, kthesa në strategjinë e Vladimir Putinit përmblidhet pikërisht në këtë. Duke mos arritur më ta marrë Kievin në tri javë, madje as në pesë vjet, ai synon të bëjë goditjen e madhe, duke shfrytëzuar prirjen e deklaruar të Donald Trumpit për ta konsideruar çështjen ukrainase si një shënim anësor, një temë pa rëndësi.

Objektivi më ambicioz ndër ata të deklaruar që prej vitit tashmë të largët 2021, të cilin synon ta arrijë tani, qoftë edhe duke përplasur grushtet mbi tryezë. Sepse klima është e favorshme për të siguruar rezultatin maksimal të mundshëm, por pas zgjedhjeve amerikane të mesmandatit, koha në dispozicion për ta arritur atë nuk është e madhe.

Sinjali i parë kishte ardhur drejtpërdrejt nga bisedimet e fundit në Abu Dabi. Sergei Riabkov, zëvendësministër i Jashtëm dhe anëtar i delegacionit rus, kishte dalë nga salla e takimeve për të deklaruar se nuk po diskutohej vetëm për Ukrainën, por për një rend të ri, të aftë për të zëvendësuar "prirjet drejt përshkallëzimit" me bashkëjetesën.

Kaq i kishte mjaftuar Vzgljad-it, gazetës online të lidhur me qarqet qeveritare dhe Kremlinin, për të njoftuar me tone triumfuese se Moska kishte "filluar të ridizenjonte sigurinë europiane".

Bllofi që po luan Kremlini

Makineria e propagandës ishte vënë në lëvizje që një javë më parë. Por mes gjithë këtyre fanfarave, po shfaqen edhe analiza më të kujdesshme, të cilat, të paktën në mënyrë të tërthortë, tregojnë se janë të vetëdijshme për bllofin që po përpiqet të luajë Kremlini.

Analiza më e kthjellët dhe më pak euforike është ajo e Elena Paninës, drejtoreshë e institutit moskovit Russtrat (Strategjia Ruse).

"Uashingtoni nuk mund t'i ketë harruar propozimet ruse të vitit 2021. Nëse kërkon një projekt të ri, e bën për të kuptuar se çfarë dëshiron Moska, në kushtet kur Finlanda dhe Suedia janë pjesë e NATO-s dhe Europa po riarmatoset. Dhe kërkon diçka në këmbim. Kërkesat e asaj kohe bëhen objekt negociatash të ndërsjella: një njohje e agjendës sonë, por edhe një mënyrë për t'i përcaktuar kufijtë e saj".

Sipas Paninës, Shtëpia e Bardhë po kalon nga politika e frenimit ushtarak në një "konkurrencë strategjike të menaxhuar", të mbështetur në traktate, për të shpenzuar më pak në Europë dhe për ta drejtuar vëmendjen diku tjetër.

"Objektivat e SHBA-së dhe Rusisë janë të ndryshëm, por për herë të parë duket se ka hapësirë për një kompromis".

Edhe kalendari është i favorshëm. Më 19 nëntor, në Shenzhen, është konfirmuar samiti i parë trepalësh mes Shteteve të Bashkuara, Kinës dhe Rusisë. Zyrtarisht, do të diskutohet për sigurinë bërthamore dhe inteligjencën artificiale, jo për Ukrainën.

Aleksei Zhuravlev, deputet ultranacionalist dhe drejtues i partisë "Atdheu", sheh pak ngjashmëri me Jaltën, përveç faktit se pjesëmarrësit janë tre dhe se Europa kontinentale nuk është ftuar, ashtu si atëherë, edhe sot.

Takimi i tre udhëheqësve

"Takimi mes udhëheqësve të Rusisë, Shteteve të Bashkuara dhe Kinës mund të hedhë padyshim themelet e arkitekturës së re të sigurisë globale, për të cilën flet presidenti ynë. Ky është një sinjal i qartë se epoka e një bote njëpolare, të dominuar nga Amerika, ka marrë fund dhe se po afron momenti për të negociuar rregulla të reja. Është pozitive që Trumpi e kupton këtë. Është e mrekullueshme që Xi Jinping mund të përfshihet në hartimin e këtyre rregullave".

Ndërkohë, Konstantin Kosachev, nënkryetar i Këshillit të Federatës, përcakton çmimin që duhet të paguajë Kievi: rikthimin te Kushtetuta e fillimit të viteve '90, që parashikonte statusin e një vendi të paangazhuar në aleanca dhe pa armë bërthamore, duke hequr aspiratën për anëtarësim në NATO, të përfshirë në Kushtetutë në vitin 2019.

Kushtet e marrëveshjes, shton ai, nuk shkruhen në Abu Dabi apo në Stamboll, "por përgjatë vijës së frontit".

Fjodor Lukianov, drejtor i revistës Russia in Global Affairs dhe drejtues shkencor i Klubit Valdai, forumit ku çdo vjeshtë Putini paraqet vizionin e tij për botën, pohon se Europa, "ashtu siç është", është "krejtësisht e papërshtatshme për negociata", por e aftë "vetëm për të mbjellë kaos".

Në gazetën Moskovskij Komsomolets, komentatori politik Mihail Rostovski bën thirrje për kujdes. Negociatat në një format më të gjerë mbeten ende abstrakte. Rusia vazhdon të mbështetet te rraskapitja e Kievit dhe te përçarjet në Perëndim, veçanërisht tek ato që mund të lindin në të ardhmen. "Bëhet ende fjalë për një lojë afatgjatë".


Por këtë herë, ajo që është në lojë nuk është më vetëm Donbasi. Dhe për Putinin, ky është tashmë një sukses. / Corriere della Sera



sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Juventusi ofron shkëmbimin e Zhegrovës me Balogunin?



TORINO, 17 NËNTOR - Skuadra e Juventusit është duke përgatitur një ofertë për sulmuesin e Monacos, Folarin Balogun, të cilin e sheh si përforcim për repartin ofensiv. Madje mediet italiane kanë raportuar se Juventusi ka propozuar shkëmbimin e tij me Edon Zhegrovën, i cili pëlqehet nga skuadra franceze.
Gjasat janë të mëdha që një shkëmbim i tillë të ndodhë në afatin kalimtar të janarit, pasi Balogun ka paralajmëruar largimin nga Monaco në fund të sezonit aktual.
Krahas kartonit të Zhegrovës, Juventusi do të ofrojë edhe para për ta bindur Monacon për këtë shkëmbim.
Zhegrova nuk shihet si pjesë e projektit të Juventusit me trajnerin Luciano Spalletti, i cili gjatë sezonit aktual nuk e ka aktivizuar në asnjë ndeshje nga minuta e parë. Ai ka nëntë paraqitje në Serinë A, ku ka realizuar dy gola dhe ka dhënë po aq asistime, ndërsa me Juventusin ka kontratë deri në verën e vitit 2030.

REY MANAJ I AFROHET REKORDIT SI GOLASHËNUESI MË I MIRË NË HISTORINË E SHQIPËRISË



TIRANË, 17 NËNTOR - Sulmuesi kuqezi Rey Manaj po kalon një periudhë fantastike, duke shënuar në dy ndeshjet e fundit ndaj Finlandës dhe Bjellorusisë, ndërsa tashmë është vetëm tre gola larg rekordit të Erjon Bogdanit.
Rey Manaj po vazhdon të dëshmojë se është një prej sulmuesve më të rëndësishëm të Kombëtares së Shqipërisë, ndërsa tashmë po i afrohet gjithnjë e më shumë një rekordi historik. Sulmuesi kuqezi është në superformë, duke realizuar nga një gol në dy ndeshjet e fundit të Shqipërisë në Ligën e Kombeve, fillimisht ndaj Finlandës e më pas kundër Bjellorusisë. Me këto realizime Manaj ka arritur në kuotën e 15 golave me fanellën e Shqipërisë, duke u renditur i dyti në listën e golashënuesve më të mirë në historinë e përfaqësueses. Përpara tij qëndron vetëm Erjon Bogdani me 18 gola, çka do të thotë se sulmuesit të Sivasporit i nevojiten edhe tri realizime për ta barazuar rekordin dhe katër për t'u bërë golashënuesi më i mirë në historinë e Shqipërisë. Pas tyre, në këtë renditje vjen Alban Bushi me 14 gola, ndërsa Sokol Cikalleshi dhe Ervin Skela kanë realizuar nga 13 gola secili. Nëse vazhdon me këtë ritëm, Manaj mund ta shkruajë emrin në historinë e futbollit shqiptar, duke u bërë golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve për Kombëtaren kuqezi.

Leipzigu e blen përfundimisht Brajan Grudën për 30 milionë euro



LEIPZIG, 17 NËNTOR - RB Leipzig do ta transferojë përfundimisht Brajan Grudën nga Brighton, pasi aktualisht futbollisti gjerman është i huazuar te skuadra e Bundesligës. Sipas gazetarit Philip Hinze të "Sky Sport Germany", detyrimi për blerjen e tij do të aktivizohet në vitin 2027 për arsye kontabël. Paketa totale e transferimit do të arrijë në 30 milionë euro, përfshirë bonuset, ndërsa Gruda do të nënshkruajë kontratë me Leipzigun deri në vitin 2031. Marrëveshja për kontratën tashmë është arritur. Në anën tjetër, Bayern Munich e ka pasur gjithmonë Grudën në listën e dëshirave, madje edhe para transferimit te Brighton. Megjithatë, ai aktualisht nuk është objektiv konkret i bavarezëve. Interesimi mund të konkretizohet vetëm nëse ndodh ndonjë zhvillim i jashtëzakonshëm, siç do të ishte shitja e Michael Olises.

ALARMOHEN GJIGANTËT EVROPIANË, MAN CITY IA CAKTON ÇMIMIN HAALANDIT

B- Manchester City duket se ka nisur të përgatitet për mundësinë e largimit të Erling Haalandit në fund të këtij sezoni, pasi është i gatshëm të negociojë shitjen e sulmuesit norvegjez për një shumë rreth 150 milionë euro.
E ardhmja e 26-vjeçarit ka filluar të vihet në pikëpyetje, ndërsa për shërbimet e tij kanë shfaqur interesim disa prej klubeve më të mëdha të Evropës, përfshirë Real Madridin dhe Barcelonën.
Sipas raportimeve nga Spanja, drejtuesit e Manchester Cityt janë të gatshëm ta hapin derën për largimin e yllit të tyre për shkak të dyshimeve të vetë futbollistit për vazhdimin e karrierës në Angli.
Këto dilema lidhen edhe me pasigurinë rreth sanksioneve të mundshme disiplinore ndaj klubit anglez, për shkak të akuzave për shkelje të rregullave financiare të Ligës Premiere.
Pavarësisht prej këtyre zhvillimeve, Haaland po vazhdon të shkëlqejë në fushën e lojës. Nën drejtimin e trajnerit Enzo Maresca, sulmuesi norvegjez ka realizuar 14 gola në 14 ndeshje zyrtare në fillim të sezonit 2026/27, duke ruajtur mesataren prej një goli për ndeshje.
Edhe pse ka kontratë me Manchester Cityn deri në verën e vitit 2034, pasiguria rreth së ardhmes së klubit mund ta shtyjë atë ta shqyrtojë mundësinë e një aventure të re.
Me çmimin e vendosur rreth 150 milionë euro, katër gjigantë të futbollit evropian kanë dalë si kandidatë potencialë për transferimin e tij në verën e ardhshme.



Real Madridi e sheh Haalandin si një përforcim të jashtëzakonshëm për repartin ofensiv. Presidenti Florentino Perez ka pasur prej kohësh interesim për sulmuesin norvegjez dhe një transferim i tillë do të ishte një tjetër goditje e madhe në tregun e futbollit. Edhe Barcelona e ka në radar sulmuesin e Manchester Cityt. Trajneri Hansi Flick thuhet se ëndërron ta ketë Haalandin në skuadër, për ta bashkuar me Lamine Yamalin dhe për të krijuar një treshe të frikshme në sulm. Në garë mund të përfshihet edhe Liverpooli, i cili synon ta përforcojë repartin ofensiv me një sulmues të nivelit të lartë. Klubi anglez mund ta shqyrtojë edhe largimin e Alexander Isakut apo Hugo Ekitikes për të krijuar hapësirë për norvegjezin. Ndërkohë, Paris Saint-Germaini ka fuqinë financiare për të përballuar një operacion të tillë si në aspektin e shumës së transferimit, po ashtu edhe të pagës së futbollistit.

Nëna e Ronaldos: Jam e lumtur që Portugalia humbi, e mashtruan djalin tim



LISBONË, 17 NËNTOR - Nëna e Cristiano Ronaldos, Dolores Aveiro, ka shkaktuar reagime me deklaratat e saj pas humbjes 4-1 të Portugalisë ndaj Danimarkës, duke thënë se disfata ishte e merituar dhe se ishte e lumtur për këtë rezultat. Ajo ka kritikuar mënyrën se si është trajtuar djali i saj nga Kombëtarja portugeze, duke pretenduar se Ronaldo nuk ka marrë respektin që meriton, madje as nga bashkëlojtarët. "Ishte një humbje dhe kështu e merituan. Jam e lumtur që Portugalia humbi. Ata nuk e respektuan Cristianon", ka thënë ajo.
Aveiro është shprehur e pakënaqur edhe me ceremoninë e nderimit për Ronaldon, duke thënë se ajo duhej të ishte organizuar në praninë e futbollistit.
"Homazhi duhej t'i bëhej në praninë e tij", ka deklaruar ajo.
Ajo ka shtuar se Sportingu, klubi ku Ronaldo e nisi karrierën, do ta nderojë siç duhet. "Është këtu, te Sportingu, do ta nderojmë atë. Këtu e njohin vlerën e tij", ka thënë Aveiro. Ndërkohë, trajneri Jorge Jesus, i pyetur për deklaratat e saj, ka thënë se i kupton reagimet dhe se ka respekt të madh për nënën e Ronaldos. "I kuptoj deklaratat e saj", ka thënë Jesus.

Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë

Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM »UNITETI-SH.A« Nr.Prot.Dorë 217 Data 28.10.2026 Mitrovicë

Bordi i Drejtorëve i KRM „Uniteti" Sh.A., Mitrovicë, në ushtrim të kompetencave të tij, në përputhje me Statutin e Kompanisë, bazuar në nenin 21, paragrafi 21.1, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, në nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, në nenin 8, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si dhe në përputhje me nenet 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, duke u bazuar në vendimin e marrë në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, të mbajtur më 20.10.2026, me numër protokolli 212, shpall këtë:

KONKURS PUBLIK
PËR PLOTËSIMIN E POZITËS

- **Titulli i pozitës:** Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)
- **Institucioni:** KRM "Uniteti" Sh.A. – Mitrovicë
- **Vendi i punës:** Mitrovicë
- **Numri i pozitave:** Një (1)
- **Kohëzgjatja e mandatit:** Tre (3) vjet nga data e emërimit, në përputhje me Statutin, aktet përkatëse të Kompanisë dhe legjislacionin në fuqi.

KUSHTET DHE KRITERET E KUALIFIKIMIT
Kandidatët/et që aplikojnë për këtë pozitë duhet t'i plotësojnë këto kushte dhe kritere:
• Të gjithë kandidatët potencial duhet të jenë persona me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d,f,j, k dhe l) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.
• Të kenë diplomë universitare në ekonomi, financë, kontabilitet ose në një fushë të përafërt;
• Të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë profesionale të dëshmuar në fushën e financave dhe/ose kontabilitetit, përfshirë përvojën në menaxhimin financiar;
• Të kenë njohuri të mira në menaxhimin financiar, kontabilitet, raportimin financiar, buxhetimin dhe kontrollin e brendshëm financiar;
• Të kenë njohuri për legjislacionin financiar e tatimor dhe rregullat që zbatohen për ndërmarrjet publike;
• Të kenë njohuri dhe shkathtësi në përdorimin e programeve financiare dhe të paketës Microsoft Office, veçanërisht Microsoft Excel.
Certifikimi profesional në fushën e kontabilitetit dhe/ose auditimit, si dhe përvoja menaxheriale në fushën financiare, përbëjnë përparësi.
Kandidatët/et duhet t'i plotësojnë gjithashtu kriteret e integritetit dhe pavarësisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE
Zyrtari Kryesor Financiar ka këto detyra dhe përgjegjësi:
• Të menaxhojë, nën drejtimin e Kryeshefit Ekzekutiv dhe brenda kufizimeve dhe autorizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve, aktivitetet dhe funksionet financiare të Kompanisë;
• Të ushtrojë kompetencat financiare dhe të autorizojë transaksione dhe veprime financiare në emër të Kompanisë vetëm brenda kompetencave dhe autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Statutin, aktet e brendshme dhe vendimet e organeve kompetente të Kompanisë;
• Të sigurojë që librat, regjistrat dhe llogaritë financiare të Kompanisë të mbahen të përditësuara, të sakta dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e zbatueshme;
• Të krijojë, zbatojë dhe mbikëqyrë sistemin e kontrolleve të brendshme financiare, përfshirë kontrollet lidhur me blerjet, faturat, pagesat, të hyrat, të dalat dhe menaxhimin e mjeteve themelore;
• Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesat e faturave dhe detyrimeve financiare të Kompanisë, në pajtim me procedurat dhe autorizimet përkatëse;
• Të kontrollojë dhe monitorojë shpenzimet e punëtorëve, me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë me politikat e Kompanisë dhe buxhetin e miratuar;
• Të përgatisë dhe të sigurojë dokumentacionin dhe shënimet financiare të nevojshme për auditimin vjetor të Kompanisë;
• Të shqyrtojë, organizojë dhe mbikëqyrë proceset lidhur me sigurimin e Kompanisë dhe mirëmbajtjen e policave të sigurimit afarist;
• Të koordinojë funksionet e tjera të biznesit me ndikim financiar, përfshirë qiratë e ndërtesave dhe pajisjeve, si dhe blerjet, në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv dhe Zyrtarin e Prokurimit të Kompanisë;

• Të menaxhojë thesarin e Kompanisë dhe të sigurojë menaxhimin e përgjegjshëm dhe efikas të mjeteve financiare;
• Të përgatisë dhe të koordinojë procesin e hartimit të buxhetit të Kompanisë dhe të monitorojë zbatimin e tij;
• Të përgatisë raporte financiare, analiza dhe informacione të tjera financiare për Kryeshefin Ekzekutiv dhe Bordin e Drejtorëve, sipas kërkesës dhe kompetencave përkatëse;
• Të bashkëpunojë me auditorët, institucionet kompetente dhe strukturat e tjera të Kompanisë për çështjet që lidhen me financat, kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar;
• Të kryejë detyra të tjera që lidhen me fushën e përgjegjësisë së ZKF-së, në pajtim me legjislacionin në fuqi, Statutin, aktet e brendshme dhe vendimet e organeve kompetente të Kompanisë.
Përgjegjësia
Zyrtari Kryesor Financiar i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të tij/saj, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe aktet e brendshme të Kompanisë.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM
Kandidatët/et duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:
• Formularin e aplikimit;
• CV-në;
• Kopjen e dokumentit të identifikimit;
• Kopjen e diplomës universitare;
• Dëshmitë për përvojën e punës;
• Dëshmitë për përvojën menaxheriale, nëse ka;
• Certifikatat profesionale, nëse ka;
• Letrën e motivimit;
• Deklaratën nën betim;
• Dokumentet e tjera të kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe procedura e konkursit.
Dokumentet e lëshuara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura dhe/ose të ekuivaluara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Kandidatët/et janë përgjegjës/e për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar.

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT

Konkursi do të jetë i hapur për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, duke filluar nga data e shpalljes në Gazetë, deri në orën 16:00 të ditës së fundit të afatit për aplikim.

Vërejtje: Aplikacionet me dokumentacion të paplotë, të pakompletuar ose joadekuat, si dhe aplikacionet e dorëzuara pas përfundimit të afatit të përcaktuar për konkurrim, do të refuzohen.
Vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs dhe përfshihen në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Aplikacionet dorëzohen fizikisht, në zarfe të mbyllura, në selinë e KRM „Uniteti" Sh.A., në Mitrovicë, gjatë orarit zyrtar të punës.
Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:
„Aplikim për pozitën – Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)"
Aplikacionet e dorëzuara pas përfundimit të afatit të përcaktuar nuk do të shqyrtohen.

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES
Procedura e përzgjedhjes zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe aktet e brendshme të KRM "Uniteti" Sh.A., si dhe me procedurat e rekrutimit që zbatohen për këtë pozitë.
Për aq sa është e zbatueshme, procedura zhvillohet edhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MFPT) Nr. 03/2024.
Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve/ve bëhen mbi bazën e meritës, profesionalizmit, transparencës, objektivitetit dhe trajtimit të barabartë.
Vendimin përfundimtar për emërimin e kandidatit/es së përzgjedhur e merr Bordi i Drejtorëve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe aktet përkatëse të Kompanisë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE
Bordi KRM "Uniteti" Sh.A. garanton mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët/et dhe siguron zhvillimin e procesit të rekrutimit pa diskriminim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Për çështjet që nuk janë të rregulluara shprehimisht me këtë konkurs, zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi, Statutit dhe akteve të brendshme të Kompanisë.

Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë

Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM »UNITETI-SH.A« Nr.Prot.Dorë 224 Data 16.11.2026 Mitrovicë

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT PUBLIK

Ndërmarrja Publike "Uniteti" Sh.A., njofton të gjithë kandidatët e interesuar dhe publikun e gjerë se, në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve, të datës 13.11.2026, me nr. të protokollit **220**, për vazhdimin e afatit të konkursit publik për plotësimin e pozitës:

Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Ky konkurs është shpallur fillimisht më datë 20.10.2026, me nr. të protokollit **212**, ndërsa konkursi publik është publikuar më datë 28.10.2026, me nr. të protokollit **217**.
Me vendimin e lartcekur, aprovohet vazhdimi i afatit të konkursit publik edhe për **15 (pesëmbëdhjetë) ditë shtesë**, në mënyrë që afati i përgjithshëm i publikimit të konkursit të jetë **30 (tridhjetë) ditë**.
Të gjitha kushtet, kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në konkursin fillestar mbeten të pandryshuara.
Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë brenda afatit të vazhduar, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkursin publik.
Për informata shtesë, kandidatët mund t'i drejtohen Ndërmarrjes Publike "Uniteti" Sh.A.

NDËRMARRJA PUBLIKE "UNITETI" SH.A.
Sekretari i Kompanisë









Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Vëllezërit e Bashkuar" Sh.p.k. Zhur, Prizren për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 26/1578/MMPH, për Eksploatim të gurit gëlqeror, Zhur, Prizren, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 09.12.2026, në ora: 11:00, në hapësirat e zyreve te Kompanisë "Vëllezërit e Bashkuar" Sh.p.k, do të organizohet debat publik nga operatori "Vëllezërit e Bashkuar" Sh.p.k. Zhur, Prizren për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 26/1578/MMPH, për Eksploatim të gurit gëlqeror, Zhur, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID:
https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09

Linku i Komunës:

Linku i gazetës ditore:


Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

"Vëllezërit e Bashkuar" Sh.p.k



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L